311/20, 318/20
29.05.2020

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Sahit Beqiri - Ekspert Shqyrtues	*Data e autorizimit të ekspertit:* 21.05.2020	*Data e dorëzimit të raportit:* 29.05.2020	Nr. i lëndës: 311/20 318/20

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **18.05.2020**, grupi i OE: **LIMIT PROJECT SH.P.K.; Mirusha Company Sh.p.k; AK - INVEST DEGA NË KOSOVË; AKSI PROJEKT SH.P.K. - Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr.: **311/20**, kurse me date **21.05.2020**, grupi i OE: **Olti Trasing, Shpk.; Sinani Ing Shpk.; Beni Dona Plast Shpk – Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr.: **318/20**, kundër **B58 njoftimit mbi vendimin** e AK, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE: **B-BARDHI SH.P.K.; Linda; EURO - INFRASTRUKTURA – Ferizaj**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i Qendrës Multifunksionale në Ferizaj - projekt trevjeçar"**, me nr. të prokurimit: 656-19-9164-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): **Komuna Ferizaj**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar: **Procedura e hapur**, lloji i kontratës: **Punë**, vlera e parashikuar e kontratës: **4.075.000.00 €**

Shënim: Ju njoftojë se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit është nxjerr një (1) vendim nga OSHJP.
Vendimi me Nr. 191, 210/19, me datë: 23.04.2020

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE NGA OE: Limit Project Sh.p.k.; Mirusha Company Sh.p.k; AK - INVEST Dega në Kosovë; Aksi Projekt Sh.p.k., - Prishtinë

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

1. Ligji nr. 03/L-215 (neni 4, pika 2 e ligjit), qe thotë: Dokumentet janë të hapura per publikun ne bazë të kërkesës se bërë me shkrim ose ne forme elektronike dhe ne rastin tonë, kemi pritur me shume se tri ore per qasje ne dokumentacionin pas afatit te caktuar nga AK, bile duke rezistuar qe të na japin dokumentacionin e kompanisë se preferuar më vete.
2. **Neni 1 – Qëllimi**
3. **Neni 6 – Ekonomiciteti / efikasiteti**
4. **Neni 7 - Barazia ne Trajtim / Jo-Diskriminim**
5. **Neni 54 – Njoftimi i kandidateve dhe tenderueseve të eleminuar**
6. **Neni 56 – Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave**
7. **Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve - Paragrafi 1,2,3,4 dhe 5**
8. **Neni 60 – Kriteret per dhënie të kontratës**
9. **Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale**
10. **Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtese Paragrafi 1, 2 dhe 3**
11. **Rregullat dhe Udhezuesi operativ per Prokurimin Publik (RrUOPP) – 39. Sqarimi i tendereve**

Ne shkeljet e vërejtura pas tërheqjes se dokumentacionit të ofertuesit të vlerësuar si i suksesshëm sipas autoritetit kontraktues Kuvendi Komunal Ferizaj, gjegjësisht grupi i operatoreve ekonomik B.Bardhi Shpk.; Linda.; EURO – INFRASTRUKTURA, komisionet kane kaluar shkelje te mëdha te cilat janë:

1. Çmimi – Grupi i OE B.Bardhi Shpk.; Linda.; EURO – INFRASTRUKTURA, ne formularin e ofertës kane paraqitur çmimin total me TVSH: **3,299,321.76 €, pas krahasimit te paramases se ofertuar dhe kontrollimit, del se grupi i OE ka bere fshehje te çmimit real, ku del vlera reale e tenderit sipas çmimeve njësi te paramses se ofertuar ne lartësin prej 3,607,660.30 €, ku diferenca e çmimit real dhe atij te paraqitur ne formularin e ofertës është 308,338.54 €, ku është shkelur neni 59 – Paragrafi 3** *Autoriteti kontraktues do te përmirësoje gabimet në një tenderë të cilat janë rënësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqofsë ky përmirësim nuk mund te jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do te konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do te konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.* Si rrjedhoje OE do të duhej te eliminohej automatikisht nga gara.
2. Ky grup i OE – ka prezantuar kamionët me korp (sipas librezës) te tipit Mercedes 508 D me tabela 662 – KS – 084, e cila nuk e plotëson kriterin e kërkuar sipas FDT pika 9.1 & 9.2 kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale pika 7.
3. Referencat e prezantuara per punë te ngjashme, nuk janë per punët e ngjashme, dhe si rrjedhoje duhet te eleminohen, per shkak se reference per ndërtimin e listuar me nr. 1 më vlere 1,000,000.00 € është jo valide sikurse ajo e listuar me nr. 4 me vlere 3,000,000.00 €, per shkak, se këto kontrata duhet te dëshmohen me leje ndërtimore dhe një pranim teknik nga një ekip profisional se punët janë kryer sipas projektit apo lejes nëse janë kryer, nëse nuk ka leje ndërtimore, atehere është objekt ilegal dhe shteti nuk duhet te favorizoje aktivitetet ilegale. Rrjedhimisht grupi i OE nuk ka plotësuar kriterin sipas FDT 9.1 & 9.2 – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale pika 1 **operatoret ekonomik apo grupi i operatoreve ekonomik duhet te ofroje një vlere per punët e kryera jo më pak se 4,500,000.00 €**, ndërsa grupi i OE ka ofruar referenca sipas asaj qe cekem më lart.
4. Tek lista e punëtorëve, punëtoret e kompanisë LINDA Bexhet Koxha, Gazmend Terzija dhe Isak Koxha, kane nënshkruar një kontratë me një person i cili është ne listën e punëtorëve, por nuk është pronar dhe as nuk ka ndonjë autorizim nga noteri apo autorizim te thjeshte per nënshkrimin e kontratave. Personi i nënshkrua si pronar i kompanisë LINDA është Afet Terzja, gjë qe, rrjedhimisht, eliminohet 3 punëtor dhe lista e punëtorëve te deklaruar bie nga 71 ne 68 punëtor, gjë qe nuk e plotëson kushtin sipas dosjes se tenderit.
5. Tek lista e te punësuarve me certifikate te sigurisë, eleminohen dy punëtor te cilët e kane nënshkruar kontratën me z. Afet Terzija, pra punëtorët Gazmend Terzija dhe Isak Koxha, eleminohen nga kjo liste per shkak se janë me kontratë te pavlefshme dhe rrjedhimisht, numëri i të punësuarve me certifikate te sigurisë te jetc: 8 nga 10 te prezantuar. Nenet te cilat janë shkelur nenet e cekura më lart.

GJETJET E SHUMTA TE TEJKALUARA NGA KOMISIONET E AK, JANË PASQYRUAR EDHE TEK GRUPI I OPERATOREVE EKONOMIK: Olti Trasing Shpk.; Sinani Ing Shpk.; Beni Dona Plast Shpk, dhe dyshohet se pas gjetjeve te shkeljeve te shumta nga komisionet e AK ne vlerësimin e këtyre operatoreve ekonomik, duke mos pasur dokumentacionin e operatoreve tjerë, ka dyshime se janë përsëritur te njëjtat shkelje. Ja disa nga shkeljet e grupit te operatoreve ekonomik: Olti Trasing Shpk.; Sinani Ing Shpk.; Beni Dona Plast Shpk..

1. Kalkulimi i çmimit: Grupi i OE ne formularin e ofertës kane paraqitur çmimin total me TVSH: 3,188,000.00 €, pas krahasimit te paramasese se ofertës se ofruar dhe kontrollimit, del se grupi i OE ka bere fshehje te çmimit real, ku del vlera reale e tenderit sipas çmimeve njësi te paramases se ofertuar ne lartësinë prej 3,823,744.17 €, ku diferenca e çmimit real dhe atij te paraqitur ne formularin e ofertës është 635,744.17 €, ku është shkelur neni 59 – paragrafi 3 *Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë rënësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqofsë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do te konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do te konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.* Si rrjedhoj OE do te duhej te eleminohej automatikisht nga gara.

S.B

2. Prezantimi i listës se punëve nuk është bindës, me shume ka pune infrastrukturore sesa pune ndërtimore te objekteve te ngjashme (ndërtim i larte)
3. Diploma e menaxherit te kontrates z. Azem Gashit, nuk është skanuar origjinali I kopjes se noterizuar, por kopja e kopjes se noterizuar, kështu qe konsiderohet e pavlefshme njëjte edhe z. Fatjon Bajselmani, gjeodeti, Fadil inxhinier hidros, njëjte edhe i elektrikes. Ne dosjen e tenderit është kërkuar kopja nga origjinali.
4. Pajisjet e kërkuar nga FDT është dashur te jenë nga: Lista e mjeteve te punës (e nënshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik per këto automjete duhet te ofroj listen e mjeteve te punës te nënshkrua dhe vulosur ne origjinal te dëshmuar me libreza te regjistrimit valide, faturë per blerjen (me dëshmi pagese), DUD doganor ne emër te kompanisë me te cilin konkurron ose grupit te operatoreve ekonomik te cilët konkurrojnë.
   a) Grupi i OE ka prezantuar: skele vetëm 2250 m^2 ne vend te 2.500 m^2 sa është kërkuar;
   b) Mungon Cisterna e Ujit;
   c) Cilindri vibrues është i huazuar, jo sipas kërkesës se FDT qe duhet te jete ne pronësi te ndonjë anëtari te konsorciumit;
   d) Është prezantuar një kontrate per paisje nga kompania vëllezërit BRAINA, por as kjo kompani nuk është anëtari i konsorciumit;
   e) Është prezantuar një kontrate me BENI – COM, ku edhe kjo kompani nuk është anëtare i konsorciumit;
   f) Automikseri është i huazuar dhe jo ne pronësi te ndonjë anëtari siç është kërkuar ne FDT;
   g) Korpa hidraulike është prezantuar e huazuar dhe jo si pronesi e ndonjë anëtari te grupit, siç kërkohet ne dosje te tenderit;
   h) Grederi mungon me dokumentacion;
   i) Janë prezantuar dokumentacionin vetëm per 5 kamion kiper, rrjedhimisht mungon një kamion kiper.
   j) Nuk është prezantuar fare kamion per transport;
   k) Piruneri nuk është prezantuar fare;
   l) Është prezantuar një minidamper, ndërkohe qe ne dosje kërkohet DAMPER, d.m.th. nuk ka prezantuar DAMPER FARE.

NE, SI GRUP I OPERATOREVE EKONOMIK; LIMIT PROJEKT SH.P.K., Minusha Company Sh.p.k., AK – INVEST DEGA NE KOSOVE; AKSI PROJEKT SH.P.K.. PASI JEMI TE PËRGJEGJSHËm ADMINISTRATIVISHT DHE TEKNIKISHT, KERKOJMË NGA AUTORITETI KONTRAKTUES TE ANULONI VENDIMET E GABUARA ME QËLLIM APO PA QËLLIM, DHE TE VENDOSNI DREJTË SIPAS LIGJIT TE PROKURIMIT PUBLIK – Ligji nr. 04/L-042, duke respektuar edhe vendimin TUAJ KU KENI APROVUAR, aprovuar sqarimin e propozuar nga ana jone per konvertim nga Banka KOMBËTARE E MAQEDONISË SE VERIUT dhe autoriteti kontraktues i kemi prezantuar edhe vërtetimin e konvertimit te HALBANK AD SKOPJE e dates 05.05.2020 duke konvertuar vlerën e denareve ne EURO me vlerën e sakt te kontratës dhe referencës e pranimit tekrik nga CAGATY per AK INVEST DOOEL.

1. Pas gjetjeve tona te paraqitura tek AK sipas nenit 52 paragrafi 7: *Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit të cilido informacioni të dorëzuar nga operatori ekonomik do të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit*, por Autoriteti Kontraktues nuk është marr fare me këtë çështje duke thyer te gjitha nenet e LPP.

Shpresojmë qe pas gjetjeve te aritmetikes nga ana jone, ju si autoritet do te bëni te njëjtën dhe ti merrni seriozisht këto gjetje dhe me veprimin e anulimit te vendimit duke na shpallur neve si OE I suksesshëm per kontratë, pasi edhe realisht ashtu jemi.

Kërkojmë nga OSHP qe të marr vendimin per anulimin e autoritetit kontraktues dhe të marr vendim që të na shpallë LIMIT PROJECT SH.P.K. dhe partnerët si operator i suksesshëm; pasi qe nuk kemi besim ne AK do te merret seriozisht me këtë çështje, duke e dërguar se ne kemi ofruar te gjitha këto informata tek AK, por çudërishtë, nuk janë marr fare por edhe vendimin e OSHP se qarkullimi i prezantuar me ardyetimin nga Banka Kombëtare e Maqedonisë se Veriut, është i rregullt. Përkundër kësaj AK, ka kërkuar sqarimi ahtesë te cilin la kemi dërguar, por e ka konsideruar te pavlefshme si përgjigjen tonë po ashtu edhe vendimin e OSHP dhe ka derguar një përgjigje refuzues ndaj kërkesës sonë pa nënshkrimin e Kryetarit dhe pa vulë si dhe pa numër protokolli. Kjo është shkelje e rende e LRP.

Lusim OSHP që të marr vendim qe ne te shpalleni si OE i suksesshëm për këtë projekt dhe te kthehet besimi ne institucionet e Republikës se Kosovës, pas gjetjeve te prezantuar më lart per kompanitë e preferuara nga AK, asnjë autoritet kontraktues i drejtë nuk mund t'i anashkalojë

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura ngu AK & DDFA) janë të njëjta me Kërkesën për Rishqyrtim në AK.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE NGA OE: Olti Trasing, Shpk.; Sinani Ing Shpk.; Beni Dona Plast Shpk – Prishtinë

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Shkeljet e dispozitave ligjore nga autoriteti kontraktues Komuna e Ferizajit Rr. Deshmorët e Kombit pn 70000 Ferizaj Republika e Kosovës; pas pranimit te njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues- aktivitetit te prokurimit i publikuar ne ueb faqen e platformës elektronike te KRPP-se me date 13.03.2020;

- Është shkelur neni 1 i Ligjit te Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (qëllimi, shfrytëzimi me efikase, me transparent dhe me i drejtë i fondeve publike) i ndryshuar dhe i plotësua me ligjin nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L068, dhe ligjin Nr. 05L-092;
- Është shkelur neni 6 i Ligjit te Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (qëllimi, shfrytëzimi me efikase, me transparent dhe me i drejt i fondeve publike) i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L068, dhe ligjin Nr. 05L-092;
- Është shkelur neni 7 i Ligjit te Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (barazia ne trajtim – jo diskriminim) i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L068, dhe ligjin Nr. 05L-092;
- Është shkelur neni 72 i Ligjit te Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë) i ndryshuar dhe i plotësua me ligjin nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L068, dhe ligjin Nr. 05L-092;
- Është shkelur neni 39 i LPP-se (Ekzamnimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve)
- Është shkelur neni 40 i RRUOPP-se (Krijimi i komisioneve vlerësues te tenderëve), - paragrafi 40.13
- Është shkelur neni 41 i RRUOPP-se (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve).

-Është shkelur neni 7 i Ligjit te Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (barazia ne trajtim – jo diskriminim) i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L068, dhe ligjin Nr. 05L-092;
-Është shkelur neni 72 i Ligjit te Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë) i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L068, dhe ligjin Nr. 05L-092;

Neni 72
Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jete jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht qe kërkesat e tilla bëhen ne përputhje të plotë me parimet e trajtimit te barabarte dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund te fitojë operatorët ekonomik për të plotesuar apo te qartesoje certifikatat dhe dokumentet e paraqitura ne pajtim me nenet 63-71 te këtij ligji.
Ne letrën standarde per tenderuesin e eleminuar te dates 06/06/2020 ne sqarim shkruan: "X Nuk keni përmbushur kërkesat mbi kapacitetin ekonomik financiar dhe kerkesat mbi mundesit teknike dhe/ose profesionale"
Me tutje ne ARSYTIM
Tenderi i juaj është refuzuar per këto arsye:

- Nuk keni përmbushur:
2. Kërkesat mbi kapacitetin ekonomik financiar dhe Kërkesat mbi mundeshit teknike dhe/ose profesionale – Kapacitetin teknik dhe profesional, duke u bazuar ne kërkesat ne dosjen e tenderit.
3.

Në arsyetimin sa i perket kërkesat mbi kapacitetin ekonomik dhe financiar Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i autoritetit kontraktues Komuna e Ferizajit Rr. Deshmorët e Kombit pn 70000 Ferizaj Republika e Kosovës, nuk ka dhënë asnjë sqarim se pse e ka shkruar se nuk plotësohet ky kriter.

Me date 06/04/2020 përmes platformës elektronike te e-prokurimit jemi njoftuar se me kontrate publike per aktivitetin e prokurimit Ndertimi i Qendres Multifunksionale ne Ferizaj – projekt trevjeçare është propozuar qe te shpërblehet me kontrate oferta e Grup operatoreve ekonomik "B-BARDHI SH.P.K.; Linda; EURO - INFRASTRUKTURA – Ferizaj

S.B

Si duket ne piken 2 gabimisht e keni shkruar 2. Kerkesat mbi pershtatshmerine profesionale duke u bazuar ne kërkesat ne dosjen e tenderit, sepse fare nuk ka te beje me te qe ju e keni shkruar.

- Është shkelur neni 6 i Ligjit te Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (ekonomiciteti dhe efikasiteti) i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L068, dhe ligjin Nr. 05L-092:

Paragrafi 1 i ketij neni thote:

1. *Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obligueara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.*

Për shkak te arsyetimeve te cekura me larte i propozojme Panelit Shqyrtues te OSHP-se, pas shqyrtimit te kesaj ankese si dhe pas konstatimeve te ekspertit shqyrtues te marren masa adekuate korrigjuese per eleminimin e leshimeve ligjore dhe te vendoset qe me kontrate publike per aktivitetin e lartecekur te prokurimit te shperblehet oferta e operatorit ekonomik "Oti Trasing" Sh.p.k. Sheshi Bil Klinton Prishtine, oferte e pergjegjeshme me emimin me te ulet qe plotesON te gjitha kriteret e specifikuara ne njoftimin per kontrate dhe ne dokumentet te cilat e perbejne dosjen e tenderit.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar: 1. Raporti auditimit dhe i pasqyrave të auditueara nga një kompani e licencuar e auditimit me reputacion për vitet (2016,2017 dhe 2018), ku kërkohet që qarkullimi i OE ose grupit të jetë jo më pak se 4,500,000.00 euro.	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* Kopje të pasqyrave në të ardhura dhe raporteve të menaxhmentit të certifikuara nga një kompani e licencuar e auditimit me reputacion për vitet (2016,2017 dhe 2018) (të bashkëngjitur kopja e noterizuar e licencës së Auditimit). **"Noteizimi i licences se auditorit eshte kopje – jo origjinal ale eshte kerkuar ne DT"** **Licenca e auditorit eshte e notrizuar me date 18/04/2017 dhe eshte e vlefshme deri me date 31/05/2020.** **Prove: Noterizimi LRP. Nr. 4628/2017**
1.Operatori ekonomik apo grupi i operatoreve ekonomik duhet te ofroje nje vlere per punet e kryera jo me pak se 4,500,000.00 €.	1.Lista e kontratave (e nenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik apo grupi i operatoreve ekonomik duhet te ofroj listen e kontratave te realizuara gjate tri viteve te fundit nga data e njoftimit per kontrate te ketij tenderi ne origjinal, te nenshkruar dhe vulosur nga OE, te deshmuar me referenca apo raporte te pranimeve teknike te puneve te kryera ne lemin e puneve te ngjashme (objekte ndertimore dhe instalime ne objekte ndertimore), te cilat tregojne vleren, daten.
Stafi profesional Menaxher i projektit. 1.Inxhinier i diplomuar i Ndertimtarise (ose master) - konstruktiv.	Verejtje Per te gjitha diplomat- kualifikimet e arritura (persona te diplomuar) ne vendet jashte Republikes se Kosoves kerkohet qe diploma e tyre te jete e nostrifikuar dhe e vertetuar ne Republiken e Kosoves. Diplomë universitare (kopje të vërtetuar–origjinal) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin Menaxheri i projektit te deshmohet me nje deklarate nga OE.
2.Nje inxhinier i diplomuar i Arkitektures (ose master)	2.Diplomë universitare (kopje të vërtetuar–origjinal) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin.
3.Një inxhinier i Gjeodezisë (bachelor ose master) - te licencuar.	3.Diplomë universitare (kopje të vërtetuar–origjinal) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin.
4.Një inxhinier i diplomuar i Ndertimtarise (ose master) - hidroteknike.	4.Diplomë universitare (kopje të vërtetuar–origjinal) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin.

5. Një inxhinier i diplomuar I Elektroteknikes (ose master)	5.Diplomë universitare (kopje të vërtetuar-origjinal) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin.
6. Një inxhinier i diplomuar i Makinerise (ose master).	6.Diplomë universitare (kopje të vërtetuar-origjinal) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin. **Te gjitha diplomat per stafin profesional duke filluar nga numri rendor nje (1) deri ne numrin rendor gjashte (6) per te cilat ju potenconi ne letren standarde per tenderusin e eleminuar se noterizimi i diplomave eshte kopje – jo origjinal sic eshte kerkuar ne DT, nuk qendrojne, sepse te gjitha diplomat e stafit profesional jane te notrizuara nga origjinali.** **Provë: diplomat e noterizuara nga noteri i autorizuar**
7. Lista e mjeteve te punës dhe ate se paku - 5 eskavator, - 6 kamion kiper, - 1 kamion per transport - 5 kamioneta per transport - 1 cilinder (vibrues), - 1 Skip me rrota me lopate para dhe krah mbrapa - 1 Pirmunier për ngarkim-shkarkim 1- Damper 1- Korpë hidraulike se paku 10 metra lartësi ngritëse - 1 grejder, -1 Autobetonjere e vogel 1- Autocisternë për ujë - 1 Vinç statik për ndërtimtari, - Skele ndërtimi së paku 2500m2.	7.Lista e mjeteve të punës (e nenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik per keto automjete duhet te ofroj listen e mjeteve ta punes te nenshkruar dhe vulosur ne origjinal te deshmuar me libreza te regjistrimit valide, future per blerjen (me deshmi pagese), dud dogunor ne emër të kompanisë me të cilën konkuron ose grupit te operatoreve ekonomik te cilet konkurojne Përgjigjie: **Lista e mjeteve te punes eshte komplete ashtu sic eshte kerkuar ne njoftimin per kontrate dhe ne dokumentet te cilat e perbejne dosjen e tenderit per aktivitetin e lartekur te prokurimit.** Provë: **Komplet lista e mjeteve te punes ashtu sic eshte kerkuar ne njoftimin per kontrate dhe ne dokumentet te cilat e perbejne dosjen e tenderit, te gjitha te shoqeruara me marreveshjet perkatese per bashkpunim me secilin antare me te cilin kemi bere marreveshje per krijimin e grupit te operatoreve ekonomik se bashku me tender jane dorezuar permes platformes se e-prokurimit.**

Autoriteti kontraktues Komuna e Ferizajit Rr. Dëshmorët e Kombit pn 70000 Ferizaj Republika e Kosovës, nuk ka respektuar Vendimin e OSHP-se me nr. te protokollit 191, 210/20 te datës 23/04/2020, ku eksperti shqyrtues i OSHP-se i ka propozuar panelit shqyrtues te OSHP-se qe lënda te kthehet ne rivlerësim, po ashtu edhe paneli shqyrtues i ka shjelluar njësi mire dokumentet dhe provat qe gjenden ne këtë lënde dhe ka pru vendim meritor ne te cilen thuhet:

I. **APROVOHEN**, si te bazuara ankesat e grupit te operatoreve ekonomik Limit Projekt" SHPK.; "Mirusha Company" Shpk; AK – Invest Dega ne Kosove SH.P.K.; "Aksi Projekt" Shpk – Prishtine dhe ankesa e grupit te OE-ve: "Oiti Trasing" Shpk.; SINANI ING SH.P.K.; Beni Dona Plast Sh.P.K. 10000 Prishtine. Lidhur me aktivitetin e Prokurimit me titull: "Ndertimi i qendres multifunksionale ne Ferizaj – Projket trevjeçar", me numer te prokurimit: 656-19-9164-5-1-1, te inicuar nga autoriteti kontraktues / AK / Komuna Ferizaj.

II. **ANULOHET**, njoftimi per dhënie te kontrates lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i qendrës multifunksionale ne Ferizaj – Projket trevjeçar", me numër te prokurimit: 656-19-9164-5-1-1, te inicuar nga autoriteti kontraktues / AK / Komuna Ferizaj dhe lënda te kthehet ne Rivlerësim

Në vendimin – Përgjigjen ne kërkesën tonë per rishqyrtim te datës 14/05/2020 me nr. 01-47/2020 ju lutem shiheni se çka shkruan Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit.

VENDIM

"REFUZOHET kërkesa e Oiti tasin Shpk, datës 13/05/202, per tenderin Ndertimi i qendres multifunksionale, me numër te prokurimit 565 – 19 – 9164 – 5-1-1".

ARYETIM

5.B

"Pas shqyrtimit te kërkese per rishqyrtim nga ana jnaj, ne si Autoriteti Kontraktues konstatojmë se pikat ankimore te paraqitura ne kërkese janë te pabazuara".

Provë: VENDIMI Nr. 01-47/2020 i datës 15/05/2020

Si duket komisioni per ri-vlerësimin e ofertave ose nuk ka qene mjaft profesional ose nuk ka dashur qe t'i shjellojë te gjitha dokumentit te cilat gjenden ne dosje, sepse asnjë dokument i vetëm nuk mungon qe ka te beje me kriteret te cilat Autoriteti Kontraktues Komuna e Ferizajt Rr. Dëshmorët e Kombit pn 70000 Ferizaj Republika e Kosovës, i ka theksuar ne leter standarde per tenderuesin e eleminuar te datës 06/05/2020.

Ne konsideroje se janë përmbushur te gjitha kushtet qe paneli shqyrtues i OSHP-se te zbatoj ndaj autoritetit kontraktues Komuna e Ferizajt Rr. Dëshmorët e Kombit pn 70000 Republika e Kosovës, zyrtarit e sidomos ndaj Zyrtarit Përgjegjës te Prokurimit te autoritetit kontraktues nener: Neni 131(Shkeljet e Ligjit nga Autoriteti Kontraktues) i Ligjit te Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (qëllim, shfrytezimi me efikase, me transparent dhe me i drejtë i fondeve publike) i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L068, dhe ligjin Nr. 05L-092;
dhe
Nenin 25 paragrafi 8 dhe 9 te këtij neni (Trajnimi i Zyrtareve te Prokurimit) i Ligjit te Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (qëllimi, shfrytëzimi me efikase, me transparent dhe me i drejt i fondeve publike) i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L068, dhe ligjin Nr. 05L-092;

Prandaj duke konsideruar se sqarimet te cilat i kemi dhënë ne kërkesë per rishqyrtim janë te mjaftushme qe te formoni nje komision te ri per ri-vlerësim dhe te bëni perseri ekzamnimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, pasi komisioni ri-vlerësues te këtë konstatuar se oferta e jone është oferte e përgjegjshme me çmimin me te ulet te propozoni qe me kontrate publike te shpërblehej oferta e grupit operatoreve ekonomik Olti Trasing, Shpk.; Sinani Ing Shpk.; Beni Dona Plast Shpk – 10000, Prishtinë. Sic shihet nga vendimet e ankimuara AK ka vepruar ne kundërshtim me aplikimin e dispozitave ligjore te lartshënuara te LPP-se dhe akteve tjera nënligjorë qe si pasoje nga shkeljet e pretenduara ka realizuar me demtimin e operatorit ekonomik Olti Trasing, Shpk, Prishtine. Kërkoje nga AK Drejtoria e Prokurimit, Zyrari Përgjegjës i Prokurimit te formoj nje komision per trajtimin e kërkese tonë per rishqyrtim per aktivitetin e lartecekur te prokurimit dhe pas shqyrtimit dhe marrjes ne konsiderate si dhe duke iu dhënë peshe te gjitha fakteve te paraqitura ne ankese – kërkese per rishqyrtim dhe pas veprimeve korrigjues, i propozojmë te merr këtë:

VENDIM

- **MIRATOHET** si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik grup operatoreve Olti Trasing, Shpk.; Sinani Ing Shpk.; Beni Dona Plast Shpk – 10000, Prishtinë
- **ANULOHET** vendimi, perkatesisht njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues – dhënie e kontrates per këtë aktivitet te lartcekur te prokurimit i publikuar ne ueb faqen e platformës elektronike te KRPP-se me date 06/05/2020.
- Te mirren masa adekuate korrigjuese per eleminimin e leshimeve ligjore dhe te vendoset qe me kontrate publike per aktivitetin e lartcekur te prokurimit te shpërblehet oferta e operatorit ekonomik grup operatoreve ekonomik Olti Trasing, Shpk.; Sinani Ing Shpk.; Beni Dona Plast Shpk – 10000, Prishtinë, si oferte e përgjegjshme me çmimin me te ulet qe plotëson te gjitha kërkesat e specifikuara ne njoftimin per kontrate dhe ne dokumentet te cilat e përbejnë dosjen e tenderit.

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK/ Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet) – ne Ankesë në OSHP, OE ankues janë të njëjta me Kërkesa për Rishqyrtim pran autoriteti kontraktues.

KRITERET PËR VLERËSIM

Të vendosen veçmërkëso kriteret çkanëse bëjnë me urdhrat e shënimeve dhe apo ato kërkesaqë lidhen me pretendimet ankimore

III.2.3) Kërkesat minimale te kualifikimit

Përshtatshmëria profesionale: : ***Dëshmia e kërkuar dokumentare***

Kërkesat:	Evidencat:
1.Certifikata e Biznesit për veprimtari adekuate. 2.Certifikata e TVSH-së.	1.Certifikata e Biznesit për veprimtari adekuate 2.Kopje- Certifikata e TVSH.

III.2.2) Kërkesat minimale te kualifikimit

Kapaciteti ekonomik dhe financiar: ***Dëshmia e kërkuar dokumentare***

Kërkesat:	Evidencat:
1. Raporti auditimit dhe i pasqyrave të audituara nga një kompani e licencuar e auditimit me reputacion për vitet (2016, 2017 dhe 2018), ku kërkohet që qarkullimi i OE ose grupit të jetë jo më pak se 4,500,000.00 euro.	Kopje të pasqyrave në të ardhura dhe raporteve të menaxhmentit të certifikuara nga një kompani e licencuar e auditimit me reputacion për vitet (2016,2017 dhe 2018) (të bashkëngjitet kopja e noterizuar e licencës së Auditimit).

III.2.2) Kërkesat minimale te kualifikimit

Kapaciteti teknik dhe professional: ***Dëshmia e kërkuar dokumentare***

Kërkesat:	Evidencat:
1.Operatori ekonomik apo grupi i operatoreve ekonomik duhet te ofroje nje vlere per punet e kryera jo me pak se 4,500,000.00 €. Stafi profesional Menaxheri i projektit. 1.Inxhinier i diplomuar i Ndertimtarise (ose master) - konstruktiv. 2.Nje inxhinier i diplomuar i Arkitektures (ose master) 3.Një inxhinier i Gjeodezisë (bachelor ose master) - te licencuar. 4.Një inxhinier i diplomuar i Ndertimtarise (ose master) - hidroteknike. 5. Një inxhinier i diplomuar i Elektroteknikes (ose master) 6. Një inxhinier i diplomuar i Makinerise (ose master). 7. Lista e mjeteve te punës dhe ate se paku - 5 eskavator, - 6 kamion kiper, - 1 kamion per transport - 5 kamioneta per transport - 1 cilinder (vibrues), - 1 Skip me rrota me lopate para dhe krah mbrapa - 1 Firmunier për ngarkim-shkarkim 1- Damper 1- Korpë hidraulike se paku 10 metra lartësi ngritëse - 1 grejder, -1 Autobetonjere e vogel 1- Autocisternë për ujë - 1 Vinç statik për ndërtimtari, - Skele ndërtimi së paku 2500m2. 8. Lista e punonjësve- Se paku 70 punëtor, ku se paku 10 prej tyre të jenë te çertifikuar për sigurinë, shëndetin në punë dhe mbroje nga zjarri. 9. Çertifikate Operatori duhet te jete i certifikuar sipas standardeve nderkombetare te menaxhimit te cilesise, me ISO certificate 9001 2015 valide 10.Operatori duhet te jete i certifikuar sipas standardeve nderkombetare te menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune, ISO Certifakate 18001 2017 (valide) ose OHSAS 18001 2007 (valide). 11. Çertifikate ISO 28841-2013. 12. Çertifikate ISO 1996 - 2 2017.	1.Lista e kontratave (e nenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik apo grupi i operatoreve ekonomik duhet te ofroj listen e kontratave te realizuara gjate tri viteve te fundit nga data e njoftimit per kontrate te ketij tenderi ne origjinal, te nenshkruar dhe vulosur nga OE, te deshmuar me referenca apo raporte te pranimeve teknike te punive te kryera ne lemin e puneve te ngjashme (objekte ndertimore dhe instalime ne objekte ndertimore), te cilat tregojne vleren, daten. Diplomë universitare (kopje të vërtetuar-origjinal) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin. Menaxheri i projektit te deshmohet me nje deklarate nga OE. 2.Diplomë universitare (kopje të vërtetuar-origjinal) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin. 3.Diplomë universitare (kopje të vërtetuar-origjinal) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin. 4.Diplomë universitare (kopje të vërtetuar-origjinal) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin. 5.Diplomë universitare (kopje të vërtetuar-origjinal) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin. 6.Diplomë universitare (kopje të vërtetuar-origjinal) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin. 7.Lista e mjeteve të punës (e nenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik per keto automjete duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne origjinal te deshmuar me libreza te regjistrimit valide, fature per blerjen (me deshmi pagese), dud doganor në emër të kompanisë me të cilën konkuron ose grupit te operatoreve ekonomik te cilet konkurojne. 8. Lista e punonjësve e nenshkruar dhe e vulosur ne origjinal nga OE te deshmuar me kontrata te punes valide., si dhe çertifikatat valide të punëtorëve të çertifikuar për sigurinë, shëndetin në punë dhe mbroje nga zjarri. 9.Te deshmohet me certificate (kopje e noterizuar) 10. Te deshmohet me certificate (kopje e noterizuar). 11. Te deshmohet me certificate (kopje e noterizuar). 12. Te deshmohet me certificate (kopje e noterizuar).

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim: (Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankuese/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Komisioni ri-vlerësuese rekomandon dhënien e kontratës Grupit i Operatoreve Ekonomik: B-BARDHI SH.P.K.; Linda; EURO – INFRASTRUKTURA, si OE teknikisht të përgjegjshme dhe me çmimin më të lirë.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA ANA EEKSPERTËVE SHQYRTUES

ESH me dt. 26.05.2020 përmes e-mail-i ka kërkuar nga AK sqarim nga AK dhe nga OE ankues "Limit Project" Sh.p.k. AK jap sqarimet lidhur me ofertat financiare dhe sqarimet e kërkuar nga OE ankues përmes e-mail-i, kurse OE jap sqarimet lidhur me pretendimet ne ofertat financiare ne ankese pran OSHP-se dhe komunikimin me AK përmes e-mail.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).
///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-sëLIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).
///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).
///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: Limit Project Sh.p.k. – Prishtine.

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se duke respektuar edhe vendimin TUAJ KU KENI APROVUAR, sqarimin e propozuar nga ana jone per konvertim nga Banka KOMBËTARE E MAQEDONISË SE VERIUT dhe autoriteti kontraktues i kemi prezantuar edhe vërtetimin e konvertimit te HALBANK AD SKOPJE e dates 05.05.2020 duke konvertuar vlerën e denareve ne EURO me vlerën e saktë te kontratës dhe referencës e pranimit teknik nga CAGATY per AK INVEST DOOEL.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/deshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, AK përmes e-mail-i dërgoi letrën standarde e kërkesës per sqarimin e tenderit me datës 04.05.2020 si ne vijim, po citoj: *"Per referencat te cilat i keni ofruar ne valuten denar, kerkojme nga ana juaj qe per këto vlera te referencave te na deshmoni me një konvertim ne valuten euro nga ajo banke ne te cilen i keni realizuar transaksionet per ato projekte"*, ndërsa OE ankues brenda afatit permes e-mail-i bashkangjet keto dokumente si ne vijim: a) Lista interne e kursit nr. 20315380, date 05.05.2020 leshuar nga HALKBANK SHA Shkup (Vulosur dhe nenshkruar nga personi përgjegjës i bankes) dhe vlera e konvertuar: 194.367.763 MKD = 3.150.502,58 EURO e përkthyer nga përkthyesi Gjygjësor z. Agron Qerreti – Prishtine, andaj bazuar ne kerkesen per sqarim nga AK, deshmin e prezantuar nga OE ankues dhe arsyetimin nga AK ne letrën standarde per tenderuesin e eleminuar, AK – komisioni i vlerësimit ka mundyr te veproj ne pajtim me **nenin 52 par. 7 te LPP-së**, po citoj: *"Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit te cilido informacioni te dorëzuar nga operatori ekonomik, do të kryejë një kontroll efektiv te informatave dhe dokumentacionit te tenderit"*.
Duke u bazuar ne këto fakte te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

SB

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: Limit Project Sh.p.k. - Prishtinë; Ndaj grupit te OE: B.Bardhi Shpk.; Linda.; EURO – INFRASTRUKTURA. - Ferizaj

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se çmimi – Grupi i OE B.Bardhi Shpk.; Linda.; EURO – INFRASTRUKTURA, ne formularin e ofertës kane paraqitur çmimin total me TVSH: 3,299,321.76 €, pas krahasimit te paramases se ofertuar dhe kontrollimit, del se grupi i OE ka bere fshehje te çmimit real, ku del vlera reale e tenderit sipas çmimeve njësi te paramses se ofertuar ne lartësin prej 3,607,660.30 €, ku diferenca e çmimit real dhe atij te paraqitur ne formularin e ofertës është 308,338.54 €,

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, si dhe duke u bzaur ne ne raportin e vlersimit te dates 06.05.2020, pasi aty komisioni i vlerësimit te DEKLARAT, nuk ka dhen asnjë arsye per eleminimin e OE pjesemarres ne kete aktivitet te prokurimit, as tek informatat lidhur me gabimet ne llogaritjet; dhe as tek informatat shtese tek sqarimet dhe rrjedhimisht komisioni i vlerësimit nuk ka respektuar vendimin per formimin e komisionit me nr. 01-33/2020 te dates 28.04.2020 si dhe nuk ka respektuar **nenin 7 paragrafi 2 të LPP-së**, po citoj: *"Autoriteti kontraktues nuk do të ukzekutojë asnjë ospeks të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që reduktion apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik"* si **dhe neni 59 par. 3 të LPP-së, po citoj:** *"Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve ndërsa ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontraktimi. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do ti dërgojë të gjitha tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla"*. Konkretisht komisioni i vleresimit, nuk ka vleresuar dhe krahasuar pershkrimin e cmimeve tek paramasa dhe parallogari te operatoreve ekonomik pjesemarrese ne kete aktivitet te prokurimit, gjithashtu eshte pergjegjesi e komisionit te vleresimit te analizoj, krahasoj dhe ekzamnioj, te zbulohen gabimet ne llogaritje dhe te gjeje perqindjen e gabimit ne llogaritje te cmimeve te ofertave finacare nga operatoret ekonomik dhe te njoftohen permes letres standarde e njoftimit per llogaritje te gabuar. Duke u bazuar ne këto fakte te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është i **qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se grup i OE B.Bardhi Shpk.; Linda.; EURO – INFRASTRUKTURA – ka prezantuar kamionët me korp (sipas librezës) te tipit Mercedes 308 D me tabela 662-KS-084, cila nuk e plotëson kriterin e kërkuar sipas FDT pika 9.1 & 9.2 kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale pika 7.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, OE ankues nuk ka dhene ndonje sqarim se pse kjo kamionet me korp (sipas librese) te tipit Mercese 308 D me tabela 662 – KS – 084, nuk plotesON kerkesen? Mirëpo bazuar ne nenin 9.1 & 9.2 pika 7 te FDT-se, po citoj: **Kerkesa 7** - *Lista e mjeteve te punës dhe ato se paku - 5 eskavator, - 6 kamion kiper, - 1 kamion per transport - 5 kamionta per transport - 1 vibrator (vibruat), - 1 Ship me rrota me lopate para dhe krah mbrapa - 1 Pirmunier për ngarkim-shkarkim - 1- Damper - 1- Korpë hidraulike se paku 10 metra lartësi ngritëse - 1 grejder, -1 Autobetonjere e vogel - 1- Autocisterrnë për ujë - 1 Vibr. shatë për ndërtimtari, - Skele ndërtimi së paku 2500m2"* **Deshmia 7:** *Lista e mjeteve te punës (e nenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik per keto automjete duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne origjinal te deshmuar me librezat te regjistrimit valide, fature per blerjen (me deshmi pagesë), dud doganor - në emër të kompanisë me të cilën konkuron ose grupit te operatoreve ekonomik te cilet konkurojne.* Grupi i OE ne listen e mjeteve ka ofruar 6 kamioneta per transport, andaj konsideroj se grupi i OE ka plotesuar kete kerekes te FDT-se. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasyh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk është i qëndrueshëm.**

5.B

Përgjigje në Pretendimi Nr. 3

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se referencat e prezantuara per punë te ngjashme, nuk janë per punët e ngjashme, dhe si rrjedhoje duhet te eleminohen, per shkak se referenca per ndërtimin e listuar me nr. 1 me vlere 1,000,000.00 € eshtë jo valide sikurse ajo e listuar me nr. 4 me vlere 3,000,000.00 €, per shkak, se këto kontrata duhet te dëshmohen me leje ndërtimore dhe një pranim teknik nga një ekip profsional se punët janë kryer sipas projektit apo lejes nëse janë kryer, nëse nuk ka leje ndërtimore, atehere është objekt ilegal dhe shteti nuk duhet te favorizoje aktivitetes ilegale.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, duke u bzaur ne Kërkesat mbi mundësitë teknikedhe/ose profesionale, **neni 9.1 & 9.2 te FDT-se**, po citoj: **kerkesa 1** *Operatori ekonomik apo grupi i operatoreve ekonomik duhet te ofrojë një vlerë per punët e kryera jo me pak se 1,500,000.00 €.* **Deshmia 1:** *Lista e kontratave (e nenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik apo grupi i operatoreve ekonomik duhet te ofrojë listen e kontratave te realizuara gjatë tri vitëve te fundit nga data e njoftimit per kontrate te kësj tenderi ne vëllimin te nenshkruar dhe vulosur nga OE, te deshmuar me referenca apo raporte te pranimeve teknike te punëve te kryera ne lemin e punëve te ngjashme (objekte ndertimore dhe instalime ne objekte ndertimore), te cilat tregojne vleren, datën.* Grupi i OE ka dorezuar listen e kontratave te nenshkruar dhe vulosur te deshmuara me kontrata dhe referenca per kryerjen e punëve te ngjashme, andaj konsideroj se grupi i OE ka arrit te plotesoj këte kerkese te FDT-së. Mirepo, AK – komisioni i vleresimit per edo dyshim te informacionit te dorezuar mund te veproj sipas nenit **nenit 52 par. 7 te LPP-se**, po citoj: *"Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit të cilido informacioni të dorëzuar nga operatori ekonomik, do të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të Tenderit"*. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është pjesërisht i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi Nr. 4

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se tek lista e punëtorëve, punëtorët e kompanisë LINDA Sh.p.k. Beshet Koxha, Gazmend Terzija dhe Isak Koxha, kane nënshkruar një kontratë me një person i cili është ne listën e punëtorëve, por nuk është pronar dhe as nuk ka ndonjë autorizim nga noteri apo autorizim te thjeshte per nënshkrimin e kontratave. Personi i nënstërrua si pronar i kompanisë LINDA është Afet Terzija, gjë qe, rrjedhimisht, eliminohet 3 punëtor dhe lista e punëtorëve te deklaruar bie nga 71 ne 68 punëtor, gjë qe nuk e plotëson kushtin sipas dosjes se tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, ankesari i grupit "Linda" Sh.p.k. ka prezantuar nje liste me 18 puntoreve te thjeshte, ne te cilen jane edhe keta punetore: Afet Terezija, Behxhet Koxha, Gazmend Terzija dhe Isak Koxha. Mirepo kesaj liste i jane bashkangjitur edhe kontratat per keta punetore, z Afet Terzija ka te nenshkruar kontrate ne poziten: Kryepunetore (e nenshkruar nga dy palet dhe te vulosur), kurse kontrata per punetoret ne fjale jane te nenshkruar nga z. Afet Teerzija – ku ne **nenin 1 te kontrates po citoj: "Te cilen e perfaqeson: Afet Terzija"** (si punedhenes – Pronar te nenshkruar nga palat dhe te vulosur me vule te fimres "Linda" Sh.p.k.).

Eksperti shqyrtues sqaron, lidhur me këtë pretendim mendon se AK – komisioni i vlerësimit, ka mundur të kërkoj sqarime shtesë bazuar në **nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së**, si dhe bazuar ne **nenin 39 te RrUOPP-së**. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është pjesërisht i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi Nr. 5

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se tek lista e te punësuarve me certifikate te sigurisë, eleminohen dy punëtor te cilët e kane nënshkruar kontratën me z. Afet Terzija, pra punëtorët Gazmend Terzija dhe Isak Koxha, eleminohen nga kjo liste per shkak se janë me kontratë te pavlefshme dhe rrjedhimisht, numëri i të punësuarve me certifikate te sigurisë te jeto: 8 nga 10 te prezantuar.

Eksperti shqyrtues sqaron, lidhur me këtë pretendim eshte sqaruar tek **pergjigjia nr. 4** mendon se AK – komisioni i vlerësimit, ka mundur të kërkoj sqarime shtesë bazuar në **nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së**, si dhe bazuar ne **nenin 39 te RrUOPP-së**. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është pjesërisht i qëndrueshëm.**

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: Limit Project Sh.p.k. - Prishtinë; Ndaj grupit te OE: Olti Trasing Shpk.; Sinani Ing Shpk.; Beni Dona Plast Shpk - Prishtinë.

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit te dosjes se tenderit, shqyrtimit te rrjedhës se procedurës se tenderimit dhe pretendimeve te palës në ankesë, sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se Kalkulimi i cmimit: Grupi i OE ne formularin e ofertës kane paraqitur çmimin total me TVSH: 3,188,000.00 €, pas krahasimit te paramasese se ofertës se ofruar dhe kontrollimit, del se grupi i OE ka bere fshehje te çmimit real, ku del vlera reale e tenderit sipas çmimeve njësi te paramases se ofertuar ne lartësinë prej 3,823,744.17 €, ku diferenca e çmimit real dhe atij te paraqitur ne formularin e ofertës është 635,744.17 €.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, si dhe duke u bazuar ne ne raportin e vlersimit te dates 06.05.2020, pasi aty komisioni i vlerësimit te DEKLARAT, nuk ka dhen asnjë arsye per eleminimin e OE pjesemarres ne kete aktivitet te prokurimit, as tek informatat lidhur me gabimet ne llogaritjet; dhe as tek informatat shtese tek sqarimet dhe rrjedhimisht komisioni i vlerësimit nuk ka respektuar vendimin per formimin e komisionit me nr. 01-33/2020 te dates 28.04.2020 si dhe nuk ka respektuar **nenin 7 paragrafi 2 të LPP-së**, po citoj: *"Autoriteti kontraktues mik do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shumë operatoreve ekonomik"* si dhe **neni 59 par. 3 të LPP-së, po citoj:** *"Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të ellur janë vërtetshi aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve shkaqofë by përmirësim nuk mund të jatë me shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontraktuar. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të veçuar të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi mbrytimet e tilla"*. Konkretisht komisioni i vleresimit, nuk ka vleresuar dhe krahasuar pershkrimin e cmimeve tek paramasa dhe parallogari te operatoreve ekonomik pjesemarrese ne kete aktivitet te prokurimit, gjithashtu eshte pergjegjesi e komisionit te vleresimit te analizoj, krahasoj dhe ekzaminoj, te zbulohen gabimet ne llogaritje dhe te gjeje perqindjen e gabimit ne llogaritje te cmimeve te ofertave finacare nga operatoret ekonomik dhe te njoftohen permes letres standarde e njoftimit per llogaritje te gabuar. Duke u bazuar ne këto fakte te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se prezantimi i listës se punëve nuk është bindës, me shume ka pune infrastrukturore sesa pune ndërtimore te objekteve te ngjashme (ndërtim i larte).

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, grupi i OE ka sjellë listen e kontratave te realizuar te nenshkruar dhe te vulosur ne vlere 5,041,614.91 €, dhe bazuar Kërkesat mbi mundësitë teknikedhe/ose profesionale, **neni 9.1 & 9.2 te FDT-se**, po citoj: **Kerkesa 1** *Operatori ekonomik apo grupi i operatoreve ekonomik duhet te ofroje nje vlere per punet e kryera jo me pak se 4,500,000.00 €.* **Deshmia 1** *Lista e kontratave (e nenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik apo grupi i operatoreve ekonomik duhet te ofroj listen e kontratave te realizuara gjate tri viteve te fundit nga data e njoftimit per kontrate te ketij tenderi ne origjinal, te nenshkruar dhe vulosur nga OE, te deshmuar me referenca apo raporte te pranimeve teknike te punëve te kryera ne lemin e punëve te ngjashme (objekte ndertimore dhe instalime ne objekte ndertimore), te cilat tregojne vleren, daten.* Andaj bazuar nga kjo konsideroj se grupi i operatoreve ekonomik plotëson kete kerkes te FDT-se. Duke u bazuar ne këto fakte te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk është i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se diploma e menaxherit te konkurrentit z. Azem Gashit, nuk është skanuar origjinali i kopjes se noterizuar, por kopja e kopjes se noterizuar, kështu qe konsiderohet e pavlefshme njëjte edhe z. Fatjon Bajselmani, gjeodeti, Fadil Inxhiner hidros, njëjte edhe i elektrikes. Ne dosjen e tenderit është kërkuar kopja nga origjinali.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, grupi i operatori ekonomik ka dorezuar diplomat e stafit profesional **(kopje te noterizuara)**, andaj dorezimi i dokumenteve permes platformes elektronike, dokumentet nuk jane origjinale por jane te skenuara, kjo eshte sqaruar edhe ne **vendimin PSH. Nr. 191, 210/2020** te dates 23.04.2020.

Eksperti shqyrtues sqaron, lidhur me këtë pretendim mendon se AK – komisioni i vlerësimit, nese ka pasur dyshime ka mundur të kërkoj sqarime shtesë bazuar në **nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së**, si dhe bazuar ne **nenin 39 te RrUOPP-së**. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika **janë pjesërisht të qëndrueshme.**

Përgjigje në Pretendimi nr.4

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se paisjet e kerkuar nga FDT është dashur te jenë nga: Lista e mjeteve te punës (e nënshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik per këto automjete duhet te ofroj listen e mjeteve te punës te nënshkrua dhe vulosur ne origjinal te dëshmuar me libreza te regjistrimit valide, faturë per blerjen (me dëshmi pagese), DUD doganor ne emër te kompanisë me te cilin konkurron ose grupit te operatoreve ekonomik te cilët konkurrojnë, pikat ne ankesë nga OE ankues si me lart ne kete raport ne faqe 3, m), n), o), p), q), r), s), t), u), v), w), dhe x)

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, bazuar ne nenin 9.1 & 9.2 pika 7 te FDT-se, po citoj: **Kerkesa 7** - *Lista e mjeteve te punës dhe ato se paku - 5 ekskavator, - 6 kamion lëpur, - 1 kamion per transport - 5 kamioneta per transport - 1 cilinder (vibrues), - 1 Ship me rrota me lopate para dhe krah mbrapa - 1 Pirnunier për ngarkim-shkarkim 1- Damper 1- Korpë hidraulike se paku 10 metro larësi ngritëse - 1 grejder, -1 Autobetonjere e vogel 1- Autocisternë për ujë - 1 Vinç statik për ndërtimtari, - Shale ndërtimi si paku 2500m2"* **Deshmia 7:** *Lista e mjeteve të punës (e nenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik per keto automjete duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne origjinal te deshmuar me librezu te regjistrimit valide, future per blerjen (me deshmi pagese), dud doganor ne emër të kompanisë me të cilën konkuron ose grupit te operatoreve ekonomik te cilet konkurojne.* Grupi i OE perveq listave te paisjeve te ofruar ne emer te grupit te OE, ai ka ofruar edhe disa marrëveshje per marrjen me qira te paisjeve, andaj AK – komisioni i vlerësimit eshte pergjegjes per ekzaminimin, vleresimin dhe krahasimin e tenderve sipas njoftimit per kontrate dhe dosjes se tenderit, duke respketuar nenin 9.1 & 9.2 kerkesa/deshmia 7 te FDT-se si dhe ne pajtim me **nenin 59 par. 4 te LPP-së**, po citoj: *"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përpulshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"*. Duke u bazuar ne këto fakte te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

S.B

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: Olti Trasing, Shpk.; Sinani Ing Shpk,; Beni Dona Plast Shpk – Prishtinë

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK – komisioni i vlerësimit ka shkelur nenin 7, 59, 108/A te LPP-se si dhe nenin 41 te RRUOPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, AK – ZPP, **nuk ka respektuar nenin 7 paragrafi 2 të LPP-së**, po citoj: "*Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën ne mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shumë operatorëve ekonomik*" si dhe **neni 59 par. 3 të LPP-së, po citoj:** "*Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet ne një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë me shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Ne një rast te tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik ne tenderin e tij financiar gjithmonë do te konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit te vetëm te çmimit total te ofruara nga operatori ekonomik ne tenderin e tij financiar gjithmonë do te konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do ti dërgojë te gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla*".

Duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne platformen elektronike e-prokurim, **eksperti shqyrtues sqaron** se AK - ZPP vendimet e njoftra ne kerkesat per ri-shqyrtim nuk i ka ngarkuar tek dosja e tenderit shto dokument shtese. Po ashtu, **AK – ZPP nuk ka respektuar nenin 108/A par. 12 të LPP-së**, ku thuhet: "Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara **në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni**, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, **në** përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë", sepse ne vendim e njoftrr nga AK te dates 14.05.2020, nuk jane arsytuar ne perputhje me LPP-në, po citoj: "Pas shqyrtimit te kerkeses per **rishqyrtim nga ana juaj, ne si autoritet kontraktues konstatojme se kerkesa juaj eshte e pabazuar**" Duke u bazuar ne këto fakte te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese ne këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi Nr. 2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK – komisioni i vleresimit – ZPP ka shkelur nenin 1, 6, te LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, OE ankues I ka paraqitur siperfaqesisht ne ankese, pa sqaruar ne deklaraten e ankese pretendimet respektivisht shkeljet qe lidhen me keto nene, andaj konsideroj se pretendimet e operatorit ekonomik ankues **jane pjesërisht te bazuara**, sepse pervec faktit se AK ka shpallur fitues grupin e operatoreve ekonomik i cili ka dorezuar oferten me emimin me te larte se sa OE ankues, sepse neni 1 dhe 6 i LPP-se flasin respektivisht obligojne te gjitha autoritetet kontraktues qe duke marre ne konsiderat qellimin dhe lenden e prokurimit jane te obliguara te sigurojne qe fondet dhe burimet publike te perdoren ne menyren me ekonomike, transparent dhe efikase.

S.B

Përgjigje në Pretendimi Nr. 3

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK – komisioni i vlerësimit – ZPP ka shkelur nenin 72 LPP-së dhe nenin 40.13 te RRUOPP-se.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, OE ankues i ka paraqitur siperfaqesishi ne ankese, pa sqaruar ne deklaraten e ankese pretendimet respektivisht ahkeljet qe lidhen me keto nene, andaj konsideroj se pretendimet e operatorit ekonomik ankues **janë pjesërisht te bazuara** pasi keto nene jane ne diskrecionin dhe pergjegjesin e autoritetit kontraktues – ZPP si dhe komisionit te vleresimit.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve ankues, ***të aprovohen si të bazuar***, dhe rekomandon të anulohet B58- Njoftimi mbi vendimin e AK (njoftimit për dhënie të kontratës) dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim.**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- *Autoritetit Kontraktues – Komuna Ferizaj*
- *Panelli Shqyrtues – OSHP*
- *Grupi i OE ankues – LIMIT PROJECT SH.P.K.; Mirasha Company Sh.p.k; AK - INVEST DEGA NË KOSOVË; AKSI PROJEKT SH.P.K. - Prishtinë*
- *Grupi i OE ankues – Olti Trasing, Shpk.; Sinani Ing Shpk.; Beni Dona Plast Shpk – Prishtinë*

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga grupi i OE: Limit Project Sh.p.k.; Mirasha Company Sh.p.k; AK - INVEST Dega në Kosovë; Aksi Projekt Sh.p.k., - Prishtinë, dhe grupi i OE: Olti Trasing, Shpk.; Sinani Ing Shpk.; Beni Dona Plast Shpk – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Qendrës Multifunksionale në Ferizaj - projekt trevjeçar", me numër të prokurimit: 655-19-9164-5-1-1, të inicuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Komuna Ferizaj.

S.B